

KONSULTIM PUBLIK

Për Raportin e Planeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Social për rehabilitimin e sistemit ujitës Xare

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në kuadër të Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes të financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), po pergatit implementimin e projektit për rehabilitimin e skemes se ujitjes Xare.

Në këtë kuader MBAZHRAU njofton publikun e interesuar se më datën 31.05.2017 në orën 11:00 në sallën e Bashkisë Konispol do të organizohet konsultimi publik nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në bashkëpunim me konsulentin Cowi as dhe nënkonsulentin Qendra e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor. Konsultimi publik do të organizohet për Raportin e Planeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Social për rehabilitimin e sistemit ujites Xare me qellim informimin e publikut, vendim marrësit dhe palët e tjera të interesuara, për natyrën e projektit dhe informim për ndikimet e rëndësishme dhe masat për zbutjen e ndikimeve negative mjedisore e sociale.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.